

VENDIM
Nr. 25, datë 8.7.2015

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN MODEL TË
SHËRBIMEVE UJËSJELLËS KANALIZIME**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, në nenin 3, nenin 13/ pika "d", nenin 14/ pika "e", "i", "j" Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në kontratën model të shërbimeve ujësjellës - kanalizime bëhen këto ndryshime:

a) Në nenin 7, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Furnizimi me ujë llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matëse. Operatori duhet të instalojë ujëmatësin për çdo Konsumator sipas legjislacionit në fuqi për metrologjinë."

b) Në nenin 7, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"a) Operatori që ofron shërbimin e furnizimit me ujë, ka përgjegjësinë ligjore të bëjë të mundur kryerjen e verifikimit periodik për matësit e ujit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar nga kjo e fundit, sipas legjislacionit shqiptar për metrologjinë.

b) Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të matësit në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të matësit. Operatori e njofton konsumatorin me shkrim për përfundimin e procedurave të verifikimit.

c) Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm të matësit do të paguhet nga:

I. kërkuesi, në rastin kur matësi ka shenjë e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;

II. përdoruesi i matësit, kur nga testimi rezulton jo në përputhje me kërkesat metrologjike.

ç) Nëse vërtetohet se ujëmatësi nuk ka funksionuar si duhet për arsye teknike dhe si pasojë vlerësimi i sasisë së ujit të konsumuar është bërë mbi bazën e leximeve të pasakta, Operatori është përgjegjës për vlerën e faturës së fundit tatimore. Nëse vërtetohet se ujëmatësi funksionon si duhet, Konsumatori detyrohet për vlerën e faturës së fundit tatimore."

c) Në nenin 7, në fund të pikës 8, shtohet togfjalëshi:

"12 muajve të fundit nga momenti i mungesës së matësit."

ç) Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura miratohen nga ERRU në bazë të një procesi ligjor dhe transparent. Procedura për vendosjen e tarifave fillon me organizimin e një seance dëgjimore me publikun, propozimin e bërë nga operatori pranë ERRU, dhënien e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Entit Rregullator të Ujit."

d) Në nenin 8, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Operatorët duhet të organizojnë një seancë dëgjimore me publikun përpara paraqitjes së propozimit për ndryshim tarife tek ERRU. Qëllimi i kësaj seance është që operatori të kontaktojë me konsumatorët duke i informuar ata rreth zhvillimeve kryesore dhe arsyes për aplikimin për ndryshim tarife."

dh) Në nenin 8, në pikën 3, fjalia e dytë ndryshon si më poshtë:

"Operatori duhet të njoftojë Konsumatorin me shkrim dhe nëpërmjet medias të paktën 30 ditë përpara aplikimit të tarifave të ndryshuara."

e) Në nenin 8 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Tarifat e shërbimeve të miratuara me vendim të Entit Rregullator të Ujit janë të detyrueshme për palët në kontratë.”

ë) Në nenin 9, pika 5 shfuqizohet.

f) Në nenin 10, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit, Konsumatori duhet të paguajë kamatëvonesën prej 0.5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 për qind e vlerës së faturës.”

g) Në nenin 10, në fund të pikës 3 shtohet togfjalëshi: “nëse aplikohet”.

gj) Në nenin 11, pika 1 dhe 2 ndryshojnë si më poshtë:

“1. Konsumatori që nuk është dakord me vlerën e faturës, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë operatorit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të faturës.

2. Konsumatorit, për çdo ankesë që paraqet, duhet t’i jepet një konfirmim zyrtar me shkrim nga Operatori që vërteton datën e dorëzimit dhe numrin përkatës të regjistrimit të ankesës.”

h) Në nenin 13, pika 3, fjalia “Vetëm persona të autorizuar nga Operatori mund të ndërhyjnë tek ujëmatësi në prezencë të Konsumatorit.” shfuqizohet.

i) Në nenin 14, pika 2/ “a”, fjalia me përmbajtje: “Kjo përfshin marrjen e masave të menjëhershme nëse është e nevojshme.” shfuqizohet.

j) Në nenin 15, pika 1 shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

“Nëse Operatori nuk e pezullon kontratën në datën e kërkuar nga Konsumatori, ky i fundit nuk është përgjegjës për konsumin e faturuar në faturat pasardhëse të shërbimit.”

k) Në nenin 15, fjalia e dyte e pikës 4, ndryshohet si më poshtë:

“Operatori është përgjegjës për realizimin teknik të rilidhjes së shërbimit brenda 2 ditëve nga data e kërkuar nga Konsumatori.”

l) Në nenin 15, pika 6 shfuqizohet.

ll) Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Konsumatori duhet që jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjidhjes së kontratës t’i paraqesë Operatorit kërkesën me shkrim duke përcaktuar datën e zgjidhjes së kontratës.”

m) Në nenin 16, pika 4, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Konsumatori është përgjegjës për të gjithë sasinë e furnizuar nga Operatori deri në datën e zgjidhjes së kontratës.”

n) Në nenin 17, pika 4 dhe 5 shfuqizohen.

o) Në nenin 18, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kundër Vendimit të Drejtuesit Ligjor të Operatorit, mund të bëhet ankim në gjykatë.”

p) Në nenin 19, pika 3, fjalia “Institucionet apo organet administrative që kanë marrë një ankesë nga konsumatori duhet të bashkëpunojnë me ERRU për informimin dhe mundësinë e zgjidhjes së këtyre ankesave.” shfuqizohet.

q) Neni 21, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Kjo kontratë hartohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”

r) Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Në rast se gjatë zbatimit të kësaj kontrate lindin mosmarrëveshje, palët do të përpiqen t’i zgjidhin këto mosmarrëveshje me mirëkuptim midis tyre dhe në rast të kundërt secila nga palët mund t’i drejtohet gjykatës.”

s) Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kushtet e përgjithshme të kësaj Kontrate, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERRU-s, sipas së njëjtës procedurë të miratimit të tyre. Operatori njofton çdo Klient mbi ndryshimet e bëra në Kontratë 30 ditë para hyrjes në fuqi të saj.

2. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERRU dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë klientët.

3. Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e Klientit, ai mund të heqë dorë nga Kontrata pa asnjë penalitet.”

2. Ngarkohet Sektori Juridik dhe Marrëdhë-nieve me Publikun për ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi